



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 309 Prot

Tiranë, më 26/2 /2016

Lënda: *Jepet mendim mbi projektligjin "Për mbrojtjen e sinjalizuesve"*

Drejtuar: KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Z. Fatmir XHAFAJ
KRYETAR

Tiranë

I nderuar Z. Xhafaj,

Projektligji "Për mbrojtjen e sinjalizuesve" i dërguar për mendim është përcjellë më parë nga organi hartues i tij, pas të cilit kemi dhënë sugjerimet përkatëse.

Sugjerimet janë parë nën dritën e ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe Opinioni 1/2006 (miratuar në 1 shkurt 2006) "Për zbatimin e rregullave të mbrojtjes së të dhënave të BE-së, për skemat e bilbilfryrësve në fushat e llogarive, kontrolleve të llogarive të brendshme, çështjet e auditimit, çështjet bankare dhe krimin financiar dhe luftën kundër ryshfetit", të Grupit të Punës të Artikullit 29 të Direktivës 95/46/EC. Në këtë argument, vlerësimi i tyre do të ishte në një linjë me kërkesat e këtyre dokumenteve.

Në projektligjin e dërguar nga ana juaj vërehet se disa prej sugjerimeve të dhëna janë reflektuar në nenin 3/4, 15 dhe 16 të tij.

Nuk rezulton të jetë ndryshuar përkufizimi i parashikuar në nenin 3/3 të projektligjit sa i takon sugjerimit të dhënë nga Zyra e Komisionerit, për të mos u përfshirë në rrethin e "Sinjalizuesve" edhe individët që kanë qenë më parë të punësuar në autoritetin publik.

Për këtë vijojmë të qëndrojmë sugjerimit të dhënë pasi edhe vetë relacioni shpjegues nuk argumenton mbi arsyen e përfshirjes së këtyre individëve. Në kushtet kur ata nuk vijojnë të jenë në marrëdhënie pune janë të barabartë me çdo individ tjetër. Për rrjedhojë çdo kush mund të jetë pjesë e kësaj skeme.

Së fundi shkronja “ç” e nenit 21 të këtij projektligji është në kundërshtim me atë çfarë parashikon ligji nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Shkeljet e konstatuara në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale sanksionohen me vendimmarrje të Komisionerit në përputhje me nenin 39 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nuk mund të jenë atribut i ILDKPKI-së.

Bashkëlidhur gjeni mendimin e dhënë më parë për këtë projektligj organit hartues, Ministrinë të Shtetit për Çështjet Vendore.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

